




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

Nr. 221/1 Prot.

Shkodër, më 31/03 / 2026

VENDIM

Nr. 04, Datë 27.03.2026

“Mbi miratimin e transferimit kapital të objekteve të investimeve të përfunduara-Ndërtim I Ujësjetllësit në fshatin Muriqan, Bashkia Shkodër” dhe “Rikonstruksion I godinës së Qëndrës Shëndetsore, Stajkë, Bashkia Vau Dejës”- nga Këshilli I Qarkut Shkodër, në Bashkinë Shkodër dhe Bashkinë Vau Dejës ”

Këshilli I Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 27.03.2026, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, “Mbi miratimin e transferimit kapital të objekteve të investimeve të përfunduara - Ndërtim I Ujësjetllësit në fshatin Muriqan, Bashkia Shkodër” dhe “Rikonstruksion I godinës së Qëndrës Shëndetsore, Stajkë, Bashkia Vau Dejës”- nga Këshilli I Qarkut Shkodër, në Bashkinë Shkodër dhe Bashkinë Vau Dejës ” bazuar në neni 14 , neni 23, neni 77 , 78, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Akt-Marrëveshjen me nr. 22693 Prot., datë 30.12.2019 të Bashkisë Shkodër dhe nr.896 Prot., datë 30.12.2019 të Këshillit të Qarkut Shkodër, Për bashkëpunimin e Bashkisë Shkodër me Këshillin e Qarkut Shkodër në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike për kryerjen e investimit me objekt “Ndërtim I Ujësjetllësit Muriqan në njesine administrative Ana e Malit “ dhe Akt-Marrëveshjen me nr. 7337 Prot., datë 30.12.2022 të Bashkisë Vau Dejës dhe nr.445/1Prot., datë 30.12.2022 të Këshillit të Qarkut Shkodër, ” Për bashkëpunim ndërvendor në fushë e Bashkisë Vau Dejës me Këshillin e Qarkut Shkodër në fushën e shërbimeve publike për kryerjen e investimit me objekt “Rikonstruksion I godinës së Qëndrës Shëndetsore, Stajkë, Bashkia Vau Dejës” Bazuar edhe ne Rregulloren për Organizimin dhe Funkionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relatimit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **14 Vota Pro, 0 Vota Kunder** dhe **0 Vota Abstenim**,

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin kapital të objektit të përfunduar të investimit “Ndërtim I Ujësjetës Muriqan, Bashkia Shkodër”, nga Këshilli I Qarkut Shkodër, në Bashkinë Shkodër, Shoqëria Rajonale të Ujësjetës Kanalizime Sh.a, me vlerë investimi në shumën **98,882,298 lekë** si dhe projektin e këtij investimi në shumën **789,999 lekë** të cilat do të kontabilizohen në librat kontabël të Shoqërisë Rajonale të Ujësjetës Kanalizime Sh.a., Bashkia Shkodër.
2. Të miratojë transferimin kapital të objektit të përfunduar të investimit “Rikonstruksion I godinës së Qendrës Shëndetsore, Stajkë, Bashkia Vau Dejës”, nga Këshilli I Qarkut Shkodër, në Bashkinë Vau Dejës me vlerë investimi në shumën **2,632,824 lekë**, shumë e cila do të kontabilizohet në librat kontabël të Bashkisë Vau Dejës.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

KRYETARI

Edmond NDOU

